



REPUBLIKA E SHQIPËRIË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

Nr. 733 Prot

Vlorë më 21.02.2025



INSTITUTI "JETA E RE"
DEGA SË SAJ LEADERIMPACT

Nr. 25001 Prot

Tiranë më 13.01.2025

MARREVESHJE BASHKEPUNIMI

NDERMJET:

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE

DHE

INSTITUTI "JETA E RE"
DEGA E SAJ LEADERIMPACT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, përfaqësuar nga Prof. Dr. Aurela Saliaj, Rektore e Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë institucion publik, me status juridik, krijuar në pajtim me nenin 57, paragrafi 7 i Kushtetutës së Shqipërisë dhe të ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

dhe

Organizatës **Instituti “Jeta e Re” dhe dega e saj Leader Impact** me adresë: Rruga Themistokli Gërmenji nr. 6, Tiranë, i përfaqësuar për lidhjen e kësaj marrëveshje me Drejtor **Z. Arbër Berhami**.

Nisur nga interesi i përbashkët për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta, konferenca të përbashkëta, leksioneve të hapura në fusha të ndryshme, apo trajnimeve të ndryshme me dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin palët bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë “**Marrëveshja**”).

Neni 1

Kjo Marrëveshje bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, gërrma c.

Neni 2

Palët në marrëveshje bien dakord të bashkëpunojnë ndërmjet tyre për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta për qëllime informuese dhe trajnuese.

Neni 3

Palët shprehen të gatshme të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, brenda mundësive të tyre dhe në respekt të politikave, procedurave dhe standardeve ligjore që garantojnë mbarëvajtjen e aktiviteteve të tyre, në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta për qëllime informuese dhe akademike.

Neni 4

Në mënyrë më specifike bashkëpunimi midis dy palëve do të konsistojë në:

1. Trajnimin e stafit akademik dhe administrativ të Universitetit të Vlorës në fushat e zhvillimit të lidershipit, zhvillimin profesional dhe personal.
2. Organizimi i seminareve dhe aktiviteteve për studentët për të promovuar aftësi të lidershipit, bashkëpunimit në grup dhe përgatitje për tregun e punës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. Organizimin e aktiviteteve/trajnimeve të përbashkëta për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore. IJR do të ndihmojë studentët e Universitetit të Vlorës me programe këshillimi për karrierën dhe zhvillim e aftësive praktike.
4. Universiteti i "Ismail Qemali" Vlorë angazhohet në dhënien e mjediseve të tij dhe kordinimin e orareve për aktivitetet për të cilat do të ketë bashkëpunim gjatë vitit akademik.
5. Aktivitete të tjera të cilat do të miratohen paraprakisht nga palët.
6. Instituti "Jeta e Re" ndalohet që në aktivitetet, takimet, seminarët që do të organizoj të ketë tema me karakter fetar.

Neni 5

Palët njohin paraprakisht se kjo është një Marrëveshje bashkëpunimi dhe përbën një dokument sipas të cilit palët deklarojnë paraprakisht vullnetin e tyre të lirë për një bashkëpunim në realizimin e projekteve dhe aktiviteteve me interes të përbashkët.

Neni 6

Kjo marrveshje lidhet me një afat 1(një) vjeçar, secila palë ka të drejtë të ndërpresë marrëveshjen aktuale duke paraqitur një lajmërim me shkrim të paktën një muaj para afatit. Universiteti ndërpret marrëveshjen menjëherë nëse konstaton se takimet, trajnimet, seminarët janë me karakter fetar.

Neni 7

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Kjo marrëveshje është hartuar në dy (2) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga një kopje do të depozitohen në **Rektoratin e Universitetit Vlorë**, një kopje do të depozitohet në **Institutin "Jeta e Re"**.
3. Për këtë marrëveshje secila nga palët përcakton personin e kontaktit për ecurinë e tij.

PËR
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË

REKTOR
PROF. DR. AURELA SALIAJ



PËR
INSTITUTIN "JETA E RE"

DREJTOR
ARBËR BERHAMI

